



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 548/1 Prot.

Pogradec, më 08.02.2021

**VENDIM**

NR. 13, DATË 05 /02 /2021

**PËR DHËNIEN E BONUSIT TË QIRASË FAMILJES NIKOLIN XHUKELLARI NË  
FSHATIN VËRDOVË, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUÇIMAS, BASHKIA  
POGRADEC, PËR SHKAK TE DËMTIMIT TË BANESËS NGA RËNIA E ZJARRIT**

Në mbështetje të nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr. 45/2019, nenet 4, 7 dhe 41, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

**VENDOSI:**

1. T'i japë familjes që zhvendoset nga banesa, me qëllim shpëtimin e jetës të pjesëtarëve të familjes së tij, ndihmën financiare prej 6000 lekë në muaj, për një periudhë 6 mujore, për përbalimin e shpenzimeve të qirasë të banesës, ku do të jetojnë:

Emër	Atësia	Mbiemri	Njësia Administrative	Fshati
1. Nikolin	Beqir	Xhukellari	Buçimas	Vërdovë

2. Kjo shumë prej 36.000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë, të mbulohet nga fondit i emergjencave civile të Bashkisë Pogradec.



Grupi	Kapitulli	Titulli	Llogaria ekonomike	Vlera
00	05	01110	6061041	36.000

3. PAGESA prej 6000 (gjashtë mijë) lekësh do kryhet, pas paraqitjes të kontratës së qirasë, në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës, pranë Bashkisë Pogradec.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Administrimit të Bashkëpronësisë, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të Bashkisë Pogradec
5. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të subjektit.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

Sotiraq MANGËRI

